



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**

Nr. \_\_\_\_ prot

Pogradec, më 11.11.2024

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit / Entit Kontraktor**

Emri Bashkia Pogradec  
Adresa Lagjja nr 2, bulevardi "Reshit Çollaku"  
Tel/Fax 083222222  
E-mail bashkiapogradec@gmail.com  
Faqja në Internet [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Personi përgjegjës: Nexhmi Torra  
[nexhmitorra@yahoo.com](mailto:nexhmitorra@yahoo.com)

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e hapur – Pune - Elektronike**

**4. Lloji i kontratës: "Punë Publike"**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-27702-11-01-2024**

**6. Objekti i kontratës: “Rikonstruksion dhe shtese objekti per shkollen “Kajo Karafili”, Geshtenjas, Bashkia Pogradec”.**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** 45210000-2 (Punime ndërtimi); 45000000-7 (Punë ndërtimi); 45232141-2 (Punime ngrohje); 45332200-5 (Punime hidraulike)

**8. Fondi limit:** 88 879 920 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

**9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:** Ndryshimi i dokumentave të tenderit do të behet mbështetur në Rekomandimet e APP nepermjet emailit te dates 08.11.2024 dhe me iniciativen e Njesise se Prokurimit per nje saktesim ne dokumentat e tenderit.

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:**

**Afati për pranimin e ofertave nuk do të ndryshojë, sipas pikës 2 të nenit 75 të LPP.**

**PERSON I AUTORIZUAR NË USHTRIM  
TE KOMPETENCAVE TË DELEGUARA  
NËNKRYETAR  
Paskalino ZIKO**

**KRYETAR  
Ilir XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

Pogradec, më 11.11.2024

SHTOJCË MODIFIKIMI

**Lënda: Modifikimi i dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt:  
“Rikonstruksion dhe shtese objekti per Shkollen “Kajo Karafili”, Geshtenjas, Bashkia  
Pogradec”**

Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec, ju bën me dije për modifikimet e Dokumentave të Tenderit, të publikuara në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe shtese objekti per Shkollen “Kajo Karafili”, Geshtenjas, Bashkia Pogradec”, me REF-27702-11-01-2024, me fond limit 88 879 920 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me date: 19/11/2024, Ora 10:00.

Autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec, në mbështetje të nenit 75 e në vijim të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, pas shqyrtimit nga Njesia e Prokurimit të rekomandimeve të APP-se me ane të emailit me date 08.11.2024, ju bën me dije për disa saktësime në pikat 2.3.1 dhe 2.4.1 të DT, dhe një saktësim në preventiv, të publikuara në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**I. Kapaciteti teknik i DT, në pikën 2.3.1, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

**ISHTE:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloragitur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

**BËHET:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

5. Formularin e vlerësimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
6. Kontratë
7. Situacionin përfundimtar;
8. Aktin e kolaudimit;

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

5. Kontrate;
6. Situacionin përfundimtar;
7. Akt kolaudimi;
8. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

**II. Kapaciteti teknik i DT, në pikën 2.4.1, behen modifikimet si poshtë:**

**ISHTE:**

- 2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i

akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Pune) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*

*Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH?*

## **BËHET:**

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet sipas zerave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë persiper të realizojë sipas akt marrëveshjes.*
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet sipas zerave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë persiper të realizojë sipas akt marrëveshjes..*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Pune) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet sipas zerave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë persiper të realizojë sipas akt marrëveshjes..*

*Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH?*

## **III. Ne preventiv, referuar citimit të markës/prodhues, “Mapej” hiqet kudo që është përmendur.**

*Argument: AK me qëllim shmangien e kufizimit të operatorëve ekonomikë, që tregtojnë produktet sipas kërkesave dhe specifikimeve të kërkuara nga AK heq emrin e markës së sipërcituar. Kjo, në mbështetje të nenit 36, pika 4, të LPP ku parashikohet se: "Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë **markë** tregtare, patentë, tipi ose **origjinë** apo prodhim specifik, me*

*qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Kjo shtojcë ngarkohet në sistemin e prokurimit elektronik, përpara përfundimit të afatit të përcaktuar për dorëzimin e ofertave dhe i'u vihet në dispozicion të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT:**